



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e katerdhjet e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **31.07.2025**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|-----------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 6. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 19. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 20. <u>Lavdije Bujupaj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajçi, LDK;</u> | 21. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 10. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Visar I Iaxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Arianit Selmanaj, LDK;</u> | 24. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 25. <u>Djula Karisik, GIBI;</u> |
| 13. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana ,përfaqësues të GIZI-it (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.facebook.com/share/v/19ZsJMGvCf/>

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Procesverbali

Kryesuesi i Kuvendit- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.
Hap punimet për mbledhjen e katerdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 25 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2025,
4. Njoftim me Raportin e punës së Kryetarit të komunës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025,
5. Njoftim me Raportin e punës së KKSB-së për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025,
6. Shpallja në Diskutim Publik mbi Planin Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025–2027,
7. Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr. 98/2025 i datës 30.05.2025
8. Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr.127/2025 i datës 25.06.2025,
9. Diskutimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Veprimit për Eliminimin e te metave të rekomanduara nga AP,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Subvencione,
11. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka?

Drejtori i Bujqesis , Astrit Hajrizaj – përshendet të gjithë të pranishmit, propozon për pik të rendit të ditës:

Aprovimi i vlersimit të demeve nga ngrtsat që kanë ndodhur në në muajin prill nga fatkeqsit natyrore.

Nexhdet Ramaj , Anëtar i Kuvendit të Komunës nga AAK- përshendet të gjithë të pranishmit, qka ka ndodhur me kerkesen tima që e kam bë për pik të rendit të dites?

Kryesuesi i Kuvendit - lidhur me kerkesen tuaj Kuvendi nuk e ka atë kompetencë që të formoj grupe vullnetare kjo është në kompetencen e kryetarit.

Hedh në votim propozimin e drejtorit Hajrizaj
kush është të votohet ky propozim?
Miratohet unanim 25 anëtar të Kuvendit prezent.

Hedh në votim rendin e ditës për sot, kush është të votohet rendi i ditës me këto propozime?

Konstatohet që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Ju njoftoj se nga OSBE - ja e kemi një iniciativ të tyre që është nënshkruar me më shumë se 60 deputet për momentin, është nënshkruar nga shumica e kryesuesve dhe keshilltarve komunal, personalitete të ndryshme. Tema është:

Komunikat mbështetse për deklaraten mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunes ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë. Është një iniciativ që OSBE-ja e ka bërë të përkrahët masivisht nga të gjithë, të gjitha kuvendet komunale në Kosovë po ashtu edhe parlamenti do ta përkrahin po ashtu.

Anëtarët e Kuvendit të komunës së Istogut e përkrahin unanimisht iniciativën e OSBE-së

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungon Florin Dreshaj dhe Faik Alushaj.

Të pranishëm në mbledhje janë 25 anëtarë të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime?

Andi Xhuraj - përshendet të pranishmit, në procesverbal me është shkruar emir mbiemri gabim.

Konstatohet që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me unanim votohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - Shqyrtimi i raportit financiar për tre muajin e dytë të vitit fiskal 2025, materialin e keni shkikuar, fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

3

Procesverbali

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – përshendet të pranishmit, bën sqarimin dhe prezantimin e Raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2025 .

Niman Beqiraj - përshendet të pranishmit, pyetë Subvencionet dhe transferet nuk janë shpenzuar, cilat projekte do të shkojnë në suficit?

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron rreth pyetjes.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi që diskutimi rreth kesaj pike mbaroj kalojm në pikën tjetër

Konstatohet që të pranishëm janë 25 anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojm me pikën e katërtë të rendit të ditës Njoftim me Raportin e punës së Kryetarit të komunës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025, fjalën e ka nënkryetari i komunës Ali Nimanaj.

Nënkryetari i Komunës Ali Nimanaj - përshendet të pranishmit, bën sqarimin dhe prezantimin e Raportit të punës së Kryetarit të komunës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.

Floriana Maxharraj – përshendet të pranishmit, raporti është bazik nuk ka analizë dhe nuk ka progress në kete raport ka mos transparenc të plot drejtori folin për plane të punës që ne nuk i kemi parë asnjeher as si qytetar as si kuvendar. Te drejtorja e inspeksionit e kemi një raport një faqe që flasin si është permbushur një plane në gjashtëmujorsh dhe ne nuk e kemi pa as një here kete plan të punës hyra dhe në uebfaqe të komunës me lyp kete planë por nuk është mendoj që nuk është në rregull mos me qenë jo transparent me ne.

Niman Beqiraj – në raportin e punës së kryetarit për pjesën e parë të vitit 2025 kemi parë që në kete raport janë nënshkruar 20 memorandume për keto tre muajt, që I bjen që tri ose 4 projekte kanë qënë financim nga qeveria çdo muaj. Ndërkaq njësia e auditimit thuhet që ka pasur aktivitet dhe ka punuar në bazë të rriskutmirë pot ë lista e puntorve aty figurojnë dy vende të lira të auditorit se nuk ka pasur puntor hiq, kjo gjendje është e përseritur vazhdimisht nese nuk ka puntor aty kush j aka dorzuar raportin Kryetarit për keto kalkulime të rriskut.

Nënkryetari i Komunës, Ali Nimanaj – sqaron pyetjet.

Negjdet Ramaj – disa projete janë të cekura që do të realizohen në vitin 2025 dua të di kur do të filloj realizimi I tyre p.sh: rruga “Liridona” në Dubrava, Rr. Në fshatin Zhallq të shala, disa rrugë në Uçë, kanalizimi në Cerkohez.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron pyetjet.

Kryesuesi i Kuvendit - A ka dikush diqka rreth kesaj pike pasi që nuk ka kalojm në piken tjetër.

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të komunës janë present.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojm me piken e pestë të rendit të dites Njoftim me Raportin e punës së KKSB-së për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025, a deshiron dikush fjalën.

Kordinator i KKSB-së, Skender Hasangjekaj – përshendet të gjith të pranishmit, bën sqarimin dhe prezantimin e Raportit te punës së KKSB-së për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.

Ajshe Metaj – përshendet të gjith të pranishmit, raporti është shumë i mire i keni përfshi të gjitha fushat, ku i keni marr këto statistika se perdorimi i substancave narkotike është nga mosha 16 vjeçare, ndoshta është mosha edhe me e re ? Ndoshta një hulumtim ne detal është me mire të jetë.

Andi Xhuraj – a ka mundesi që gjatë zones së veres të merren zjarrfiksa sezonal p.sh 6 ose 7 që të shtohet kapaciteti i zjarrëfiksve, 3 zjarrfiksa janë pak.

Kordinator i KKSB-së, Skender Hasangjekaj – sqaron rreth pyetjeve.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka dikush tjetër diqka pasi që nuk ka kalojm në piken tjetër.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e gjashtë të rendit të dites: Shpallja në Diskutim Publik mbi Planin Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025-2027 Materialin e keni pasur a ka dikudh diqka?

Pasi që nuk ka hedh në votim.

Konstatojmë që nga 22 anëtarë të Kuvendit të komunës miratohet unanim.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e shtatë të rendit të dites Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr. 98/2025 i datës 30.05.2025, a deshiron dikush fjalën me rekomandim të MAPL vendimi e kanë kthyer në rishqyrtim materialin e keni pasur a deshiron dikush diçka?

Ajshe Metaj – A kini me ndryshu ju diçka aty, nese nuk ndryshoni diçka aj perseri ka me u kthy .

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron.

Niman Beqiraj – ndoshta mund të jetë ndonjë arsyetim por ne nuk e kemi materialin.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron.

Andi Xhuraj – rishqyrtimi i ketij vendimi a konsiderohet si veprim i ri, në rast se po a kemi të drejt ne si Kuvend komunal me miratu prona në kohë të zgjedhjeve?

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron pyetjet.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka dikush tjeter diçka pasi që nuk ka hedh në miratim Nga 22 anëtar të Kuvendit që janë prezent, 18 votuan për dhe 4 abstenim.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e tetë të rendit të dites Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr.127/2025 i datës 25.06.2025, a deshiron dikush fjalën me rekomandim të MAPL vendimi e kanë kthyer në rishqyrtim materialin e keni pasur a deshiron dikush diçka?

Kryesuesi i Kuvendit- a ka dikush tjeter diçka pasi që nuk ka hedh në miratim Nga 22 anëtar të Kuvendit që janë prezent, 18 votuan për dhe 4 abstenim.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e nënt të rendit të dites Diskutimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Veprimit për Eliminimin e te metave të rekomanduara nga AP, a deshiron dikush diçka?

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – përshendet të pranishmit, bën sqarimin dhe prezantimin e Diskutimi i Raportit të Auditorit të

Përgjithshëm për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Veprimit për Eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP.

Agron Gashi – përshendet të gjithë të pranishmit, dua një sqarim nga djertori edhe me grandin e performances ne në vitin e kaluar jemi përballur prap me drejtorin për keto gjetje. Pse vit pas viti po perseriten gjetjet e auditorit po e shohë si defekt tonin edhe të komunës që duhet me e pranuar përveq sqarimeve tjera edhe tek pjesa e performances komunat tjera po dalin ma mirë se na kështu që duhet me i shiku të gjitha edhe të vitit kaluar keto 15 pika që i kemi munges të punës tonë që nuk ju rrimi të gjitha gjerave gati ketë sqarim deshta me e bë pse komunat tjera po marrin me miljona e ne dalim keq në raportet e performances por edhe të transparences.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron.

Fjolla Ukaj - përshendet të gjithë të pranishmit, kam dy pyetje :

Vonesa e realizimit të projekteve ky e sqaroh shumë mirë që ka qen mungesa e mjeteve financiare në dispozicion por nuk e ceku edhe një koment të cilin e ka jep auditori ku është edhe vonesa në shpronsimin e pronave si është e mundshme me u qit në tender me u jep një rrug mu asfaltu ku nuk është bere shpronsimi i pronës dhe pyetja e dytë është mos Egzistenca e teri veturave të jepet një sqarim mjefat mirë për neve këtu në letren e konfirmimit kryetarit që e ka kthyer zyres së auditorit thot që pajtohet me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e raportit. Pse nuk është kthyer edhe ky koment të auditori njejen si na laburove neve.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj - sqaron.

Ajshe Metaj – faktikisht nga opinion na vjen keq i komunes ton që ka dal i kualifikuar por faktikisht fai po I hidhet kontrates kolektive fillimisht kemi kerkuar me e ber një zgjidhje pa shku të permbaruesi kish qëne mire me bë një marrveshje.

Kur ka filluar me u implement kontrata kolektive në cilin vit ka filluar komuna me pagu këto kontrata kolektive.

Qështja e vetuarave u aluburua, mungesa e inform, atave të menagjimit të punëve?
Auditimi i brendshem i komunës?

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron.

Niman Beqiraj - përshendet të gjithë të pranishmit, raporti i auditorit është raporti me i rendesishem në qeverisjen tonë që tregon për mangesit edhe për perparsit që ka ndodh me pasurit e komunës gjatë atijë viti, edhe është munmdesi e mirë për me mior një grant që me mujt me investu me shumë vitin e kaluar është fituar dhe ka qenë një merit që është marr por që nuk e ka pasur as një ankesë tek raporti i auditorit . Zyra e auditorit janë të pa varur dhe jnë me shumë se gjysma e të gjeturave të vitit kaluar që nuk janë përfunduar këtë vit.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – sqaron.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka dikush tjeter diçka pasi që nuk ka hedh në miratim miratohet unanimit.

19 anëtar të Kuvendit janë present.

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e dhjetë të rendit të dites Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Subvencione, a deshiron dikush diçka?

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj -bën sqarimin dhe prezantimin e Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Subvencione,

Agron Gashi - kam disa rekomandime për këtë rregullore:

Pika 3 mbështetja për klubet dhe sportet pjesmarrese në gara ndërkombetare

3.1 mbështetja financiare për klubet sportive që përfaqsojnë komunën në gara zyrtare ndërkombetare të organizuara nga federata të njohura ndërkombetarisht (si: UEFA, EHF, FIBA, CEV, etj.) përcaktohet në përputhje me rendesin e garave dhe mundesit e buxhetit të komunës.

3.2 klubet që përfaqsojnë komunat në gara të tilla do të mbështeten automatikisht me një shumë minimale prej 10,000 euro për sezon.

3.3 Mbështetja për sportistët individual përcaktohet mbi bazen e arritjeve në gara zyrtare ndërkombetare të organizuara nga federatat përcaktohet dhe mund të jetë në shpërblimi apo mbulimi të kostove.

3.4 nuk konsiderohet si garë zyrtare ndërkombetare turni jozyrtarë, rekreativ, festivë apo të hapura, të cilat nuk janë të njohura nga federatat kërkatese kombetare ose ndërkombetare. Por mund të mbështetet varesisht prej mundesive buxhetore, nese konsiderohet që kanë ndikim në masovizmin e sportit të caktuar apo aprovimin e aktiviteteve sportive të rinis.

Arsim:

Përkrahja e nxënësve - fitues në garat regjionale, shtetërore apo ndërkombetare:

2.1 vendi i parë - 350 të behet 1000 euro

2.2 vendi i dytë - 200 të behet 500 euro

2.3 vendi i tretë - 150 të behet 300 euro.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj -bën sqarimin.

Floriana Maxharraj - kjo rregullore është një dokument i rëndësishëm për funksionimin efikas dhe të drejt për ndarjen e paras publike gjatë analizës shihet që ka shumë nevoj për përmirësime gjysore , teknike dhe përmbajtësore në anën tjeter rregullorja është për tu pelqyer ku përkrahët kategorit të cilat. Disa I tha Agroni nuk po I përmendi por mendoj që rregullorja duhet të jetë me e përmbushur p.sh të shumë nene kemi mundur me opas plotësime si ka munges të afateve për aplikim.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj –bën sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit - hedh në votim propoziment e Agronin për Arsim

Kush është që të hynë keto propozime

Nga anëtarët e Kuvendit miratohen unanim.

A ka dikush tjetër diçka pasi që nuk ka, hedh në miratim miratohet unanim.

16 anëtar të Kuvendit janë present.

Shqyrtimi i pikës 11.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e njembdhjetë të rendit të dites Aprovimi i vlersimit të demeve nga ngrtsat që kan ndodhur në në muajin prill nga fatkeqsit natyrore, a deshiron dikush diçka?

vazhdojm me piken e fundit a deshiron dikush diçka?

Shqyrtimi i pikës 12.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e fundit të rendit të ditës: të ndryshme

Ajshe Metaj - Rruga Saradran – Lluga është një kthes se di sa e ke pa drejtor kerkoj të vendosen një mbrojtese nese është përgjegjesi e Komunës sepse është me rrezik.

Drejtori për Sherbime Publike, z. Abedin Kabashi – përshendet të pranishmit, bën sqarimin.

Valbone Demaj – përshendet të gjithë të pranishmit, kam një kërkes për ndriqimin Publik në lagjen “Mahaj” dhe në të gjith fshatin si dhe një pjesë në fshatin Baicë të lagja “Morinve” dhe në Dubovë të Vogel.

Ruzhdi Metaj - përshendet të gjithë të pranishmit, në fshatin Këliqan deri ku kan shku procedurat e ndriqimit të fshatit?

Drejtori për Sherbime Publike, z. Abedin Kabashi – përshendet të pranishmit, bën sqarimin.

Andi Xhuraj – përshendet të gjithë të pranishmit, kam dy pyetje një vjen nga zyrtaret komunal për qështjen e shujtave ne e kemi marr një vendim kur planifikon egzekutivi me i egzekutu mjetet.

Propozimin që e kam ber për lirimin e taksave në QKMF në Istog për zyrtaret Policor e di se egzekutivi ka kerkuar që të lirohen edhe nga pagesat në gjendjen civile, dua t konfirmoj a është e sakt dhe a ka filluar të zbatohet.

Kryesuesi i kuvendit – sqaron rreth pyetjeve.

Negjdet Ramaj – kam një kerkes nga banoret e fshatit Shushic e uletë rruga nga burgu i Dubrave të lagja “Metaj” nuk ka as një shenjë në rrugë kanë kerkuar të ketë një stop të rruga ku lidhet me rrugen kryesore Rakoshin me Istogun. (aty ka pasur aksidente të vogla). Në fshatin rakoshë është vendosur ndriqimi publikë por me shumë në shtylla të improvizuara dhe po ka defekte rregullishtë a ka ndonjë plan me e bë sin ë Uçë. Për fshatin Uçë kam një kerkesë rruga “Ramë Alia” pa shku të shkolla që të vendosen disa shtylla elektrike 5 ose 6 me bashkfinancim për shkak që janë shumë të demtuara ato kablllo elektrike ka vazhdimish problem.

Drejtori për Shërbime Publike, z. Abedin Kabashi – përshendet të pranishmit, bën sqarimin.

Arta Balaj – përshendet të gjithë të pranishmit, pastrimi me i shpesht i trotuareve dhe mexhave për të gjitha fshatrat e Istogut dhe të Istogut.

Drejtori për Shërbime Publike, z. Abedin Kabashi – përshendet të pranishmit, bën sqarimin.

Niman Beqiraj – drejtori abendin duhet me na falëndero se pari ne që ja kemi jep gjysmë milioni shtesë kompanisë te mbeturinave rritja e çmimeve një here 5 tani 6 tash 7 aty është thëne pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave në qendrat urbane me ketë çmim nuk është bere ajo është dashur është dashur me e jep edhe gjysmë milioni tjetër. Në Vrellë i kemi pasur disa kërkesa së pari në qendër qe janë dal do far ulësesh aty janë do gozhda njerëzit mund të lëndohen aty.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Abedin Kabashi – sqaron

Fjolla Ukaj - kam një pyetje nga familja Vuthaj duan të din pse nuk e kanë marr një përgjigje nr. I lëndës 009-553/5054 kërkesa është bere me 12 shkurt për ndiem financiare për shërim.

Agron Gashi – kam disa pyetje për drejtorin e shërbimeve publike si dhe disa pyetje që lidhen me drejtorin tjera. Kisha disa pyetje per disa zona turistike te Lugut te Bute dhe Moknes dhe këto pjese kane nevoje per mirëmbajtje. E para eshte menaxhimi i mbeturinave dhe nëse eshte mundësia drejtor me dërguar nje kontejner te madh, dhe disa te vogël qe te paktën me shkuar nje here ne jave qe me i hcq, sepse ne sezonin veror eshte mc e ngarkuar sesa dimrit. Te dy pjesët e këtyre e kane nga nje park te vogël aty qe eshte nder arsyet kryesore pse shkojnë njerëzit atje. Ato zona kane filluar te dëmtohen, prej veturave prej motorëve dhe nëse ka mundësi per disa rrethoja qe me i ruajtur këto ambiente nëse ato veq kane filluar te dëmtohen. Te pjesa e mirëmbajtjes e di qe eshte edhe pjesa e Ministrise, por edhe ne si komune sa kem kapacitet me i mirëmbajtur ato qofte veres apo dimrit. Te pjesa tjetër eshte edhe elektrifikimi , a keni mëndur ndonjëherë si drejtori me e zhvilluar, e me dërguar edhe elektrifikimin atje.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Abedin Kabashi.

Abedin Kabashi- sigurisht ne me kompaninë "Ambienti" jemi ne kontakt te vazhdueshëm javor, ne aktivitetet qe zhvillohen ose ne Luge te Bute ose ne Mokne çdoherë eshte nje kamionete dhe nje staf i tyre, ndërsa ditëve te tjera jo. E kemi menduar me kryeshefin aktual me e gjetur formatin se si me e kryer kete. Sigurisht edhe ne kete drejtim do te bëjmë diçka. Ndersa lidhur me elektrifikimin pa shkuar rryma elektrike eshte ne kosto qe sigurisht KEDS ka me ndermarre hapa qe me e dërguar rrymën e kur e kemi rrymën eshte mundësia qe me e ndriçuar hapësirën atje. E sa per rrethoja per mbrojtëse ne nuk kemi mundësi shkak qe eshte investim i ministrisë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit-fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj-arsyeja qe kërkova me herët qe pergjigjet e drejtove te shkruhen ne procesverbal eshte se nuk po mundem me e gjet ne procesverbal temën e lirimit te taksave te stacionit Policor. Se aty shkruan drejtori sqaron.

Kryesuesi i Kuvendit- e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Falënderon të gjithë për durimin qe patën, dhe kontributin e dhënë,
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

